



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 e datës 22 nëntor 2012, nenit 18 pika 2 të Rregullores QRK NR.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 18. 12. 2015, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, miratoi këtë :

VENDIM

PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET, oferta e përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1. N.T.SH. "AL-TEC", është shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Prona e paluajtshme e Komunës, gjindet në fshatin Babush i Muhagjerëve, Zona kadastrale Babush, me sipërfaqe prej 1.00,00 ha (1 hektar) nga pjesët e parcelave kadastrale nr.P-71409059-00555-0 dhe nr.P-71409059-00559-0, kullosë e klasës së 4 e evidentuar në çertifikatën nr.14-6302 dhe çertifikatën nr.14-6303.
3. Shfrytëzimi i pronës do të jetë 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
4. Në pronën e cekur do të ushtrohet veprimtaria : Fabrikë për prodhimin e ushqimit të qenëve dhe maceve.

Neni 2

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Zyra e Kryetarit të Komunës - sektori pronesor-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

15Nr. 464-01541

Lipjan, më 21. 12. 2015

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

